



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.74/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada - Glllogjani anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjekteve politike Samostalna Liberalna Stranka (SLS) dega në Graçanicë dhe subjektit politik Gradanska Iniciativa Serpska Lista (GISL), dega në Graçanicë, për shkak të vendosjes së posterave në rrugë dhe në hapsira publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit i mbajtur me datë 07.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) me seli në Prishtinë, dhe subjekteve politike Samostalna Liberalna Stranka (SLS) i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1,200.00 (njëmijë e dyqind) euro, ndërkaq subjektit politik Gradanska Iniciativa Serpska Lista, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1,200.00 (njëmijë e dyqind) euro.

II. Subjekti politik SLS dhe subjekti politik Gradanska Iniciativa Serpska Lista, **DETYROHEN** ti paguajnë gjordat e shqiptuara si në pikën - I - të dispozitivit të këtij vendimi, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 05.06.2017, nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) me të cilën pretendon se me datën 04.06.2017 në rrugën “Princi Lazër” (rrugë kryesore) në qytezën e Graçanicës, monitoruesi ka hasur në poster të subjekteve politike Samostalna Liberalna Stranka dhe Gradanska Iniciativa Serpska Lista, të ngjitura në hapsirë publike përkatësisht në transformator të energjisë elektrike . Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë i datës 06.06.2017 subjektet politike Samostalna Liberalna Stranka (SLS) dhe Gradanska Iniciativa Serpska Lista (GISL), i kanë pranuar shkeljet e pretenduara sipas ankesës duke e arsyetuar se subjektet politike SLS dhe GISL e respektojnë Ligjin nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregullën

Zgjedhore nr.11/2013 të KQZ-së, Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Kandidatët dhe Simpatizantët e tyre dhe për më tepër kanë theksuar se të gjithë aktivistët i kemi njoftuar qartë lidhur me udhëzimet se në qfarë mënyre dhe ku lejohet të ekspozohen posterët e subjekteve politike gjatë kohëzgjatjes së fushatës zgjedhore . PZAP-it i kanë kërkuar që mos t'iu shqiptohet ndonjë sanksion apo gjobë ndaj subjekteve politike SLS dhe GISL .

Prandaj përmes kësaj shkrese zyrtare - Përgjigjes në ankesë, PZAP-in e ka njoftuar se do të zhvillojnë procedure hetimore me qëllim të vërtetimit të aktivistëve që kanë vendosur postere në vende publike të palejuara. Subjektet politike SLS dhe GISL i kanë vendosur posterët e kandidatëve për deputet nga radhët e tyre, pas marrjes së ankesës nga ana e PZAP-it, kanë ndërmarrë masat përmirësuese për evitimin e shkeljes sipas ankesës. Përgjigjes në ankesë si prove për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkangjitur një fotografi nga vendi ku është larguar posteri .

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterat e kandidatëve për deputet nga radhët e subjekteve politike SLS dhe GISL janë vendosur në hapsirë publike përkatësisht në transformator të energjisë elektrike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në objekte dhe në rrugë publike”*.

Duke u nisur nga gjendja e theksuar faktike, Paneli konstaton se nga prova e ofruar shihet qartë se nga ana e subjekteve politike Samostalna Liberalna Stranka (SLS) dhe Gradanska Inicijativa Serpska Lista (GISL), është shkelur neni 33 pika (b) i Ligjit nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), pasi që posterat e kandidatëve për deputet nga subjektet politike SLS dhe GISL janë vendosur në transformator të energjisë elektrike. Të cilën shkelje e kanë pranuar edhe vetë subjektet politike SLS dhe GISL, në përgjigje në ankesë i datës 06.06.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike SLS dhe GISL kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara, që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore dhe për kundër këtij fakti posterat e kandidatëve për deputet nga radhët e subjekteve politike SLS dhe GISL janë vendosur në transformator të energjisë elektrike, pra në hapsira publike të qytetit . Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e morri parasysh edhe faktin se subjekteve politike në fjalë, ia dha mundësinë për tu përgjigjur sipas kërkesës për përgjigje në ankesë dhe Urdhërit për ndërrmarjen e masave përmirsuese, ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi .

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 i LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.74/2017 më datën 07.06.2017.

Kryesuesi i Panelit
Zyhdi Haziri



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.